



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 86, datë 29.12.2016

P Ë R

**PËRCAKTIMIN E VENDNDODHJES SË TERMINALIT JUG-LINDOR TË
AUTOBUZËVE NË BASHKINË E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1. shkronja "b", nenit 23, pika 6 dhe 14, nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, për "Vetëqeverisjen vendore"; nenit 21/1, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 për "Transportet Rrugore" (i ndryshuar); nenit 12, të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 për "Planifikimin e Territorit" (i ndryshuar), me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë vendndodhjen e terminalit lindor të transportit të autobusëve në Bashkinë e Tiranës sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi si Aneksi nr.1.
2. Të miratojë përfshirjen në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë së Tiranës të gurmës/vendodhjes së përcaktuar në Aneksin nr. 1. Gjurma të përfshihet ligjërisht dhe teknikisht në kategorinë e përdorimit të tokës dhe njësive strukturore në të që kushtëzojnë zhvillimin e terminalit jug-lindor të transportit të autobusëve, në përputhje me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 për "Planifikimin e territorit" (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.
3. Të ngarkojë strukturat përgjegjëse të Bashkisë së Tiranës të lidhin një marrëveshje me Prasin Investment AL Sh.A. për garantimin e investimit me fondet e Prasin Investment AL Sh.A. dhe operimin e terminalit jug-lindor të transportit të autobusëve prej kësaj të fundit për me së paku 20 vjet.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI

